

Regjistrimi për të votuar

FAQ (pyetjet e bëra më shpesh)



Si të regjistrohem për të votuar?

Plotësoni një formular regjistrimi për votuesin dhe paraqitjani atë personalisht ose me postë NYC Board of Elections (BOE). Ju mund të shkarkoni formular regjistrimi nga faqja e internetit të BOE (www.vote.nyc.ny.us), të merrni një në zyrën lokale të BOE, në shumë pika të kujdesit ndaj klientit të agjencive NYC, ose të telefononi 866-VOTE-NYC (212-487-5496 për personat me vështirësi në dëgjim) për ta kërkuar një me postë. Banorët e NY mund të regjistrohen gjithashtu internet (shiko më poshtë). Afati i fundit për vulën postare dhe paraqitjen e regjistrimeve personalisht është 25 ditë para zgjedhjeve ku ju doni të votoni.

A mund të regjistrohem për të votuar në internet?

Regjistrimi në internet mund të bëhet përmes DMV, por kërkohet një dokument identifikimi i vlefshëm të Shtetit të Nju Jorkut. Vizitoni faqen e internetit të DMV për të ndërtuar një profil dhe për t'u regjistruar në: <http://dmv.ny.gov/more-info/electronic-voter-registration-application>.

Nuk e di nëse jam i regjistruar për të votuar, si mund ta gjej këtë?

Përdorni regjistrimin e votuesit (<http://voterlookup.elections.state.ny.us>) për të kontrolluar në internet statusin e regjistrimit tuaj, ose telefononi 866-VOTE-NYC për ndihmë.

A mund që regjistrimi im të ketë skaduar?

Regjistrimi juaj nuk ka datë skadimi, por mund të bëhet joaktiv nëse ju nuk keni votuar në dy zgjedhjet e fundit qeveritare, ose nëse ju jeni transferuar dhe nuk e keni ndryshuar adresën në BOE.

Po sikur të jem transferuar brenda Qytetit të Nju Jorkut që nga hera e fundit që kam votuar?

Kur transferoheni, ligji i Shtetit të Nju Jorkut ju kërkon të ndryshoni adresën me BOE brenda 25 ditësh. Mund ta bëni këtë duke paraqitur një formular të ri regjistrimi për votim dhe duke plotësuar në të informacionet, përfshirë edhe informacionet në kutinë me emër "Informacionet e votimit që kanë ndryshuar". Shkruani adresën tuaj të re dhe të vjetër, shënoni kutinë për partinë në të cilën doni të regjistroheni (bëjeni këtë edhe nëse ishit të regjistruar në një parti me adresën e vjetër), dhe jepni çdo informacion tjetër të kërkuar. Nëse jeni transferuar por nuk e keni ndryshuar adresën para afatit në BOE, ju duhet të shkoni në pikën e re të votimeve dhe të votoni me fletën e vërtetimit të votimit. Telefononi 866-VOTE-NYC për të mësuar nëse është bërë ndryshimi i adresës suaj.

A ndikon ndjekja penale në të drejtat e mia për t'u regjistruar dhe për të votuar?

Ju **nuk** mund të regjistroheni ose të votoni nëse ju jeni dënuar për një vepër penale dhe që për atë vepër penale:

- Ndodheni aktualisht në burg; ose
- Jeni nën mbikëqyrje lirim me kusht.

Ju mund të regjistroheni dhe të votoni nëse ju jeni dënuar për një vepër penale dhe që për atë vepër penale:

- Jeni dënuar në lirim me kusht;
- Nuk jeni dënuar me burg ose dënimi me burg është pezulluar;
- Keni bërë dënimin maksimal në burg, në të cilin rast ju jeni në gjendje të ri-regjistroheni për të votuar;
- Keni qenë në lirim me kusht dhe jeni liruar, në të cilin rast ju jeni në gjendje të ri-regjistroheni për të votuar;
- Keni marrë faljen.

A ndikon dënimi për keqbërje të lehta në të drejtat e mia për t'u regjistruar dhe për të votuar?

Ju mund të regjistroheni dhe të votoni, qoftë edhe nga burgju, nëse ju jeni dënuar vetëm për një keqbërje të lehtë. I njëjti rregull zbatohet në qoftë se ju jeni dënuar në gjykatën e Nju Jorkut, në gjykatën e një shteti tjetër apo në një gjykatë federale. Ju nuk keni nevojë të jepni dokumente mbi dosjen tuaj penale (kriminale) për t'u regjistruar dhe për të votuar.

Aktualisht jam i pastrehë. A mund të regjistrohem dhe të votoj?

Po, ju keni të drejtën të regjistroheni dhe të votoni. Plotësoni formularin e regjistrimit për votim dhe shkruani një vend ku ju mund të gjendeni, si për shembull “Stoli në Central Park dhe në Rrugën 86,” si adresa ku jetoni. Ju do t'ju caktohet një pikë votimi duke u bazuar në këtë adresë. Shkruani adresën e një strehe, kutinë postare, ose një pjesëtar të familjes si adresën ku ju merrni letrat postare. Karta juaj e votimit do t'ju dërgohet në këtë adresë.